

	SYLLABUSI I PROGRAMIT TË TRAJNIMIT		F-042
	Prishtinë	v. 2.0	Faqe 1 nga 5

Kodi: 058-1

HULUMTIMI NË VEPRIM

Tipi i programit: Themelor

Hyrje

Programi i trajnimit “Hulumtimi në veprim” është zhvilluar nga KEC në vitin 2013, në kuadër të Programit për Arsim Themelor (BEP), për të ndihmuar arsimin kosovar në zhvillimin e shkathtësive relevante të shekullit 21 të nxënësit të shkollave fillore dhe të mesme të ulëta. Në atë kohë, gjatë zbatimit të programit, janë trajnuar 177 mësimdhënës dhe janë pranuar rreth 100 raporte të hulumtimit.

Përshkrimi i programit të trajnimit:

Për programin e trajnimit “Hulumtimi në veprim” pjesëmarrësve potencialë nga shkollat fillore, të mesme të ulëta, apo të mesme të larta, së pari do t’u dërgohet një pyetësor përmes të cilit ata i përgjigjen disa pyetjeve, të cilat çojnë në krijimin e idesë (abstraktit të punimit) se çfarë problematike arsimore ata dëshirojnë të trajtojnë në hulumtimin e tyre. Pas kësaj, pjesëmarrësit vijojnë trajnimin i cili realizohet në tri ditë të ndara në një shtrirje kohore prej tetë javësh.

Pas ditës së parë të trajnimit në të cilën mësimdhënësit marrin njohuri për hulumtimin në veprim, ata kanë dy-tri javë periudhë kohore për të kryer punë rreth hulumtimit të tyre në shkollë. Ndërmjet ditës së parë dhe të dytë, mësimdhënësit mbajnë kontakt me trajnerët (online ose takim me trajnerët dhe pjesëmarrësit tjerë) për t’u konsultuar dhe reflektuar rreth ecurisë së hulumtimit. Gjatë kësaj kohe, pjesëmarrësit vazhdojnë punën individuale në shkollë dhe shtëpi dhe takohen në ditën e dytë të trajnimit, ku prezantohet pjesa e punës së kryer deri në këtë fazë. Pastaj vazhdojnë me punë individuale (hulumtimin e tyre në shkollë) edhe tri-katër javë tjera. Gjatë kësaj periudhe, mësimdhënësit komunikojnë me trajnerët dhe kolegët e grupit përmes platformave elektronike ose përmes takimeve reflektuese, ku mundësohet që ata të shkëmbejnë përvojat dhe qartësojnë dilemat rreth hulumtimit, dhe të finalizojnë punën rreth raportit (artikullit) të hulumtimit. Në fund, mësimdhënësit mbajnë ditën e tretë të trajnimit, me ç’rast secili prej tyre prezanton raportin final me të gjeturat nga hulumtimi i realizuar, ndërsa trajnerët dhe kolegët japin informata kthyesë.

Raporti final i hulumtimit në veprim mund të publikohet në platforma edukative, si shembull për mësimdhënësit tjerë.

 KEC Qendra për Arsim e Kosovës Kosova Education Center	SYLLABUSI I PROGRAMIT TË TRAJNIMIT		F-042
	Prishtinë	v. 2.0	Faqe 2 nga 5

Qëllimet e trajnimit:

- Kuptimi i rolit të mësimitdhënësit si hulumtues në klasën/shkollën e tyre dhe përparësitë që ka hulumtimi në veprim;
- Aftësimi i mësimitdhënësve që të identifikojnë situata problemore të lidhura me mësimitdhënien, të nxënësve dhe arsimin në përgjithësi;
- Aftësimi i mësimitdhënësve për planifikimin dhe zhvillimin e një cikli të hulumtimit në klasë/shkollë;
- Shfrytëzimi i hulumtimeve në veprim si një burim për hulumtimet e mëtutjeshme në fushën e arsimit;
- Përmirësimi i praktikave të mësimitdhënies dhe arritjeve të nxënësve.

Rezultatet e të nxënësve

Pas përfundimit të trajnimit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- identifikojnë situata/probleme të lidhura me mësimitdhënien, të nxënësve dhe arsimin në përgjithësi;
- shqyrtojnë literaturë profesionale dhe shkencore në lidhje me çështjet arsimore;
- reflektojnë rreth praktikës së tyre profesionale në kontekst të përmirësimit të vazhdueshëm dhe në interes të përmirësimit të rezultateve të nxënësve në klasë/shkollë;
- analizojnë lidhjet në mes të teorisë dhe praktikës në fushën e arsimit duke vendosur hulumtimin në klasë/shkollë në një kontekst të ndërvuar;
- zhvillojnë projekte të hulumtimit në klasë apo shkollë ku punojnë dhe të shkruajnë raportin e atij hulumtimi;
- bashkëpunojnë me 'miqtë kritik' për të reflektuar për vlefshmërinë e hulumtimeve në klasat e tyre.

Përmbajtja

Temat që trajtohen gjatë programit të trajnimit përfshijnë:

- Hyrje në metodologjinë e hulumtimit në veprim,
- Përkufizimi, qëllimi dhe llojet e hulumtimit në veprim,
- Identifikimi i problemeve në klasë/shkollë dhe diskutim për gjetjen e zgjidhjeve të mundshme,
- Hapat e HV:
 - o Identifikimi i problemit ose temës hulumtuese

	SYLLABUSI I PROGRAMIT TË TRAJNIMIT		F-042
	Prishtinë	v. 2.0	Faqe 3 nga 5

- Mbledhja dhe organizimi i të dhënave
- Analiza dhe interpretimi i të dhënave
- Plani i veprimit
- Raportimi
- Planifikimi i projektit të HV /Diskutim i përbashkët në grupe,
- Prezantim i planifikimeve të projekteve hulumtuese,
- Reflektime për punën e bërë,
- Diskutim për realizimin e planeve të veprimit: Sukseset /vështirësitë,
- Analiza e të dhënave dhe shkrimi i raportit të HV,
- Planifikimi i hapave të mëtejme në projektet hulumtuese,
- Prezantim i raporteve të HV,
- Përmbledhje dhe vlerësim.

Grupi i synuar

Programi i trajnimit është konceptuar për t'u ofruar për të gjithë mësimdhënësit e arsimit parauniversitar, duke u shërbyer atyre të bëhen profesionistë reflektues. Megjithatë, programi mund të ndiqet edhe nga profesionistët tjerë arsimorë në shkollë, që mund të ofrojnë mbështetje për mësimdhënësit, si: koordinatorët e cilësisë në shkollë, etj.

Forma e organizimit / Kohëzgjatja

Programi i trajnimit "Hulumtimi në veprim" do të zbatohet si në vijim:

1. Trajnimiti treditësh (18 orë)

Punëtoritë udhëhiqen nga 2 trajnerë të aftësuar nga KEC. Për të realizuar hulumtimin e tyre, pjesëmarrësit ndihmohen edhe nga mentorë/trajnerë tjerë, sipas nevojës. Secila nga tri ditët e trajnimit ka nga katër sesione pune 90-minutëshe. Në total kjo fazë e trajnimit konsumon 18 orë kontaktuese, dhe pjesëmarrësit kanë obligim të vijojnë 90% të këtyre orëve, respektivisht mund të mungojnë më së shumti në një sesion 90-minutësh.

2. Aktivitetet në shkollë - punë hulumtuese individuale e mësimdhënësve

Përmbajtja e trajnimit do të zbatohet nga të gjithë mësimdhënësit e ciklit fillor dhe të mesëm të ulët, të përkrahur nga trajnerët dhe 'miqtë kritik'. Aktivitetet në shkollë organizohen në dy periudha. Cikli i parë i hulumtimit në veprim zhvillohet pas ditës së parë të kursit kur përcaktohet se çfarë dëshirojmë të shqyrtojmë, vendoset se çfarë të dhënash do të mblidhen, dhe krijohet një pyetësor testues. Në këtë

	SYLLABUSI I PROGRAMIT TË TRAJNIMIT		F-042
	Prishtinë	v. 2.0	Faqe 4 nga 5

fazë, mësimdhënësit fillojnë me realizimin e planeve të veprimit dhe mbledhjen e të dhënave të hulumtimeve të tyre. Faza e dytë e punës së mësimdhënësve realizohet pas ditës së dytë të trajnimit me qëllim të analizës së të dhënave dhe rishikimit të planeve të veprimit, ku përshkruhet se si mund të shfrytëzohen dhe të zbatohen rezultatet e gjetura. Po ashtu në këtë fazë, mësimdhënësit shkruajnë raportin (artikullin) e hulumtimit të tyre dhe rezultatet diskutohen dhe ndahen me të tjerët.

3. Mbështetja e mësimdhënësve nga trajnerët / kolegët (12 orë)

Për të mbështetur mësimdhënësit gjatë punës së tyre hulumtuese, organizohen së paku dy takime reflektuese me pjesëmarrësit, sipas nevojës. Trajnerët takohen individualisht ose në grupe me mësimdhënësit për të diskutuar fazat e realizimit të projekteve hulumtuese në klasat apo shkollën e tyre. Takimi i parë realizohet ndërmjet punëtorisë së parë dhe të dytë, kurse takimi i dytë, ndërmjet punëtorisë së dytë dhe të tretë. Para ditës së tretë pjesëmarrësit janë të obliguar të hartojnë raportin e hulumtimit, i cili duhet të aprovohet nga trajnerët mentorues. Kjo pjesë e konsultimeve zhvillohet përmes komunikimit elektronik, përmes të cilit pjesëmarrësit shkëmbejnë draftet e raportit të tyre me trajnerët dhe kolegët, dhe marrin sugjerimet/komentet në formë të shkruar.

Po ashtu, inkurajohen takimet e shkurtra/seancat reflektuese të shkëmbimit të përvojave mes kolegëve. Në total kjo fazë e trajnimit konsumon 12 orë me takime të reale ose virtuale me kolegët e grupit të moderuara nga trajnerët(përmes mjeteve elektronike, email ose platforma komunikimi në grup).

Mësimdhënësit do të inkurajohen të shfrytëzojnë hulumtimin në veprim si pjesë e integruar e mësimdhënies së tyre. Hulumtimet e realizuara në klasë duhet të jenë në përputhje me parimet dhe kompetencat kryesore që kërkohen me Kornizën e Kurrikulës së Kosovës.

Vlerësimi/Certifikimi

Programi ka gjithsej 30 orë të plota. Për zbatimin e trajnimit “Hulumtimi në veprim” janë caktuar aktivitetet në vijim:

1. Organizimi i një projekti hulumtues në periudhën 8-javëshe;
2. Shkrimi i raportit (artikullit) të hulumtimit të realizuar;
3. Vetëvlerësimi dhe vlerësimi i kolegëve për prezantimin e raportit të hulumtimit.

Kusht për certifikim është pjesëmarrja e kursit mbi 90%, origjinaliteti i raportit, vlerësimi pozitiv i raportit (artikullit) të hulumtimit nga trajnerët, vetëvlerësimi dhe vlerësimi i kolegëve për prezantimin e raportit të hulumtimit.

 KEC Qendra për Arsim e Kosovës Kosova Education Center	SYLLABUSI I PROGRAMIT TË TRAJNIMIT		F-042
	Prishtinë	v. 2.0	Faqe 5 nga 5

Materialët e trajnimit

Dokumenti kryesor për programin e trajnimit është udhëzuesi për trajnerë, i cili ndihmon trajnerët që ta ofrojnë programin me sukses. Ofrimi i programit përkrahet me prezantime në Power Point, ndërkaq materialet tjera krijohen nga vetë pjesëmarrësit mbi bazën e hulumtimeve të bëra, duke u kthyer edhe në materiale burimore për të gjithë pjesëmarrësit.

Ndërkohë, pjesëmarrësit pajisen edhe me udhëzuesin “Hulumtimi në veprim”, që u shërben gjatë mësimdhënies së tyre.